
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: "JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K. me adresë në Junik Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	28.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **25.10.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K.** me adresë në **Junik**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-8684-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-056-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K.** me adresë në **Junik**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-8684-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-056-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **09.10.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-8684-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-056-5-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K. me adresë në Junik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-8684-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-056-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **09.10.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **25.10.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

- Në lidhje me pretendimin ankimor të Kërkesës nr.1 se është i panevojshëm prezantimi i dëshmimeve nga banka ose konfirmim bankar për obligimet ndaj punëtorëve në 6 muajt e fundit dhe se është e mjaftueshme paraqitja e listave nga ATK-ja, sepse me këtë fakt dëshmohet se paguhen kontributet e punëtorëve dhe janë të deklaruar në ATK, ne si Autoritet Kontraktues e kemi vendos këtë kërkesë me qëllimin që të ofertojnë kompani serioze të cilat i paguajnë pagat e punëtorëve sepse po ka raste që vetëm kontributet po paguhen ndërsa punëtorët nuk po janë drejtpërdrejtë të kyçur në kompani. Po ashtu kjo kërkesë rrit edhe nivelin e sigurisë për punëtorë dhe mbrojtjen e tyre, ndërsa kjo kërkesë nuk duhet të paraqet asnjë pengesë për kompanitë të cilat i paguajnë tatimet dhe kontributet e ATK-së dhe që i kanë punëtorët pjesë të kompanisë. Nxjerrja e një dokumenti nga Banka nuk kushton asgjë më shumë dhe nuk merr kohë më shumë se sa një vërtetim tjetër nga ATK-ja, prandaj kërkesa për të ndryshuar këtë dëshmi të kërkuar nuk është e arsyetuar, prandaj **refuzohet si e pa bazuar**.
- Në lidhje me pretendimin ankimor për ***Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, në vlerë prej: 1,800,000.00 €, mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania, duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjale, ose mbështetje të pakushtëzuar nga Institucioni Bankar, duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia***, ne si Autoritet Kontraktues e kemi vendos këtë kërkesë që të vlerësohet nëse tenderuesi ka stabilitetin e mjaftueshëm financiar dhe ekonomik, sepse ky projekt është mjaft i madh dhe nuk mund ta kryen çdo kompani, mirëpo vlera e kërkuar është brenda suazave ligjore. Po ashtu është lënë hapësira e mjaftueshme që të ofrohet edhe mbështetje bankare për ato kompani të cilat nuk kanë mjete të gatshme në llogari, kështu që kërkesa është në përputhje të plotë me nenin 8 të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim Publik.

- Pretendim ankimor tjetër është se Baza për prodhimin e asfaltit me kapacitet minimal prej 240 tone/orë është shume e larte për shumicën e projekteve, dhe e kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike që kanë pajisje me kapacitet me të vogël por që janë me se të mjaftueshme për realizimin e punëve në këtë projekt. OE ankues kërkon që të vendoset një minimum me i arsyeshëm prej 140 tone/ore, duke rritur konkurrencën dhe duke shmangur kostot e panevojshme.

Kjo kërkesë e OE ankues nuk është argumentuar me asnjë dëshmi, ndërsa në si Autoritet Kontraktues tek secila kërkesë kemi pasur parasysh projektin dhe natyrën e tij si dhe qëllimin që duhet të arrihet. Në këto projekte kapaciteti i bazës për prodhim të asfaltit duhet të jetë më e madhe, ndërsa OE mund të ofertojnë edhe në grup dhe të plotësojnë këtë kërkesë nëse eventualisht nuk e ka ndonjë kompani bazën për prodhimin e asfaltit.

Përderisa lejohet ofertimi në grup dhe kjo kërkesë nuk është kufizuese atëherë nuk është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues së nuk është respektuar neni 28 i LPP-së, pasi që nuk është kërkesë kufizuese e as diskriminuese një kërkesë e tillë, e po ashtu ka të bëjë me natyrën dhe qëllimin e këtij projekti.

- Pretendimi ankimor tjetër është në lidhje me mjetet dhe stabilimentet ku është kërkuar të largohen dëshmitë e noterizuara të makinerive dhe të atyre që merren me qira me arsyetimin se është e mjaftueshme lista e makinerive e noterizuar dhe se krijohen shpenzime të panevojshme.

Kjo kërkesë e OE ankues nuk është bindëse dhe e argumentuar, ndërsa pse janë kërkuar të noterizuara dëshmitë për pajisje dhe marrëveshje më qira është vetëm për shkak të sigurisë për tu arritur qëllimi i këtij aktiviteti të prokurimit, pra për tu përfunduar kontrata në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa. Lista e makinerive që është kërkuar e noterizuar nuk është e mjaftueshme për të garantuar siguri se OE posedojnë pajisjet, ndërsa kur notëzohen edhe dëshmitë e pajisjeve atëherë këto dëshmi tregojnë për stabilitet të kompanisë. Ky projekt është i rëndësishëm dhe kur kemi parasysh vlerën e projektit, atëherë kostoja e shpenzimeve për noterizime të këtyre dokumenteve nuk mund të jetë e lartë në krahasim me qëllimin e kësaj kërkesë dhe të projektit në përgjithësi.

Kërkesa për noterizim të dëshmvive dhe arsyetimi se ka kosto më shumë noterizimi i dokumenteve nuk është bazë për të konsideruar se nuk është respektuar neni 7 i LPP, sepse shuma e noterizimit të dokumenteve nuk e kufizon asnjë kompani për tu përgatitur për ofertim dhe se kjo kërkesë vlen për të gjithë ofertuesit prandaj nuk kemi diskriminim apo favorizim të ndonjë kompanie me këtë kërkesë.

- Pretendim ankimor tjetër është në lidhje me mjetet dhe stabilimentet ku është kërkuar të largohen disa specifika apo të lejohet tolerancë më e madhe, e në disa raste të ulet minimumi i kërkesave.

Pasi që pretendim ankimor ka të bëjë me natyrën e njëjtë të specifikave të pajisjeve përkatësisht tonazhen në përgjithësi atëherë po japim një përgjigje të përgjithshme për këtë pretendim pavarësisht që bëhet fjalë për disa pajisje.

Për disa pajisje është kërkuar minimumi e për disa është kërkuar minimumi dhe maksimumi, që do të thotë se është lënë hapësira e mjaftueshme përkatësisht toleranca e tonazhes, prandaj këto kërkesa nuk kanë të bëjnë me diskriminim apo favorizim.

- Sa i përket Dronit profesional ku OE ankues ka pretenduar se përdoret vetëm për terrene vështirë të kalueshme, ne si Autoritet Kontraktues e kemi vendosur si kërkesë për shkak të rëndësisë së projektit përkatësisht punëve gjeodezike që ka ky projekt, kur kemi parasysh faktin se droni është një pajisje e avancuar për të përfunduar shërbimet e nevojshme për këtë projekt. Edhe në këtë rast dronin mund ta ketë ndonjë anëtarë i grupit dhe të mbulohet kjo kërkesë sepse nuk ka ndonjë kufizim për këtë pajisje që ta ketë vetëm lideri.

Droni nuk është i destinuar vetëm për teren të papërshtatshëm por është pajisje e avancuar e cila përdoret në të gjitha rastet dhe në çfarëdo tereni. Droni është një pajisje për të realizuar matjet gjeodezike në njërin prej mënyrave dhe në këtë rast nuk ekziston kërkesë kufizuese dhe nuk mund të largohet kjo kërkesë.

Të gjitha kërkesat e kontestuara nuk kanë të bëjnë me kufizime të konkurrencës dhe janë të gjitha sipas ligjeve dhe rregulloreve të prokurimit publik duke krijuar hapësira dhe tolerancë edhe tek specifikat e pajisjeve por të gjitha kërkesat që janë vendosur në dosje të tenderit janë vendosur për të siguruar konkurrencë të pastër dhe profesionale sepse ky projekt ka të bëjë me një rrugë e cila ka filluar të rregullohet në vitin 2019, ndërsa ka mbetur pa u realizuar kjo kontratë e cila ka qenë e kontraktuar për shkak të dështimeve të kompanisë. Kur kemi parasysh këto rrethana atëherë ne si Autoritet Kontraktues kemi vendosur kritere ligjore dhe profesionale por duke pas në konsideratë që ky projekt mos të na dështojë edhe njëherë sepse po vuajnë edhe qytetarët me proceset e stërzgjatura të përfundimit të punimeve.

Këto kritere nuk përbejnë bazë për trajtim jo të barabartë siç ka pretenduar OE ankues prandaj nuk është shkelur neni 7 i LPP, pasi që OE ankues nuk ka arritur të dëshmojë pretendimin për shkelje të nenit 7 të LPP.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues se nuk është respektuar neni 10 i LPP, ne si autoritet kontraktues nuk kemi vërejtur që ky OE ka ofruar ndonjë dëshmi për mosrespektim të transparencës, prandaj është i pabazuar ky pretendim.

Po ashtu nuk është ofruar asnjë dëshmi se nuk janë respektuar edhe dispozitat e nenit 1 dhe 69 të LPP dhe nenit 19 dhe 25 të RrPP Nr.001/2022, prandaj janë plotësisht të pabazuar pretendimet për shkelje të këtyre neneve.

Autoriteti kontraktues më rastin e vendosjes së kriterëve dhe kërkesave të tjera lidhur me nenin 68 dhe 69 të LPP ka pasur parasysh çdo herë faktin e mundësisë së ofertimit në grup dhe atë sipas nenit 71 të LPP dhe nenit 26 të RrPP Nr.004/2022, ku konkretisht shkruan tek neni **26.1** Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik, kurse neni **26.5** Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një Autoritet Kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Gjithashtu në lidhje me këto kërkesa, ne nuk kemi pranuar asnjë vërejtje apo rekomandim nga Komisioni Rregullativ Për Prokurim Publik e që ky fakt tregon se të gjitha kërkesat janë në harmoni me legjislacionin e prokurimit publik.

Këto sqarime dhe përgjigje tregojnë që nuk ka kufizim të konkurrencës dhe kërkesa për rishqyrtim e OE ankues është e pabazuar dhe refuzohet.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në **pajtueshmëri me objektin e kontratës**. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmimeve mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit